

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT TIRANË
NR. 6683

Ka adm. te fje

V E N D I M

MBI RIREGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Në Tiranë sot më dt.13.9.1993 unë gjyqtarja e gjykatës së rrethit Tiranë, Florina Tegu, mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga kërkuesi "ITALDRURI ELBASAN" shpk me administrator Antonio Ammendola, për riregjistrimin e shoqërisë.

K O N S T A T O V A s e:

Kërkesa e paraqitur nga kërkuesi "ITALDRURI ELBASAN" shpk me administrator Antonio Ammendola për riregjistrimin e shoqërisë për të ushtruar veprimtarinë e vet në fushën e prodhimit dhe tregtimit e gjysëm produkteve dhe produkteve të përpunuara prej druri ndër të cilat: dërrasë e sharruar, parket, kompesato, rimeso, fibër, punime të mobilerisë (karrige, divane, dollapë, bufe etj.,) porta dhe dritare, panele zdrukthi, etj. Shoqëria gjithashtu do të realizojë vepra civile dhe industriale (vepra hidrike, kanalizime, impiante pastrimi uji, gazsjellës, ndërtesa civile, rrugë, etj), si dhe administrimin e shërbimeve të çdo lloji (shërbime ujore, urbane për ujitje, shpërndarje të gazit të metanit, etj?). Shoqëria do të zhvillojë çdo aktivitet tjetër të lidhur me ato të përmendura më sipër duke futur dhe transportin e materialeve të ndryshme, mirmbajtjen dhe riparimin e mjeteve të transportit dhe kualidimin e tyre, pyllëzimin dhe ripyllëzimin e tyre, prerjen dhe transportin e trupave, shfrytëzimin e pyllit, etj.

Është e drejtë dhe në bazë të ligjit duhet pranuar.

PËR KËTO ARËSYE

Në bazë të ligjës 7667 dt.28.1.1993.

V E N D O S A

Riregjistrimin e shoqërisë "ITALDRURI ELBASAN"shpk me admistrator ANTONIO AMMENDOLA si person juridik për të ushtruar aktivitetin privat në fushën e prodhimit dhe tregëtimit e gjysëm produkteve dhe produkteve të përfunduara prej druri,ndër të cilat;dërrasë e sharruar,parket,kompesato,rimese,fibër,pradhime të mobilerisë(karrige,divane,dellapë,bufe,etj),dyer dhe dritare,panele zdrukthi,etj.Shoqëria gjithashtu do të realizojë vepra civile dhe industriale(vepra hidrike,kanalizime,implante pashtrimi uji,gazsjellës,si dhe ndërtesa civile,rrugë,etj),si dhe administrimin e shërbimeve të çdo lloji(shërbime ujore,urbane dhe për ujitje,shpërndarje të gazit të metanit,etj).Shoqëria do të zhvillojë çfardo aktivitet tjetër të lidhur me ato të përmendura më sipër duke futur dhe transportin e materialeve të ndryshme,mirëmbajtjen dhe riparimin e mjeteve të transportit dhe koaludimin e tyre,pyllëzimin dhe ripyllëzimin e tyre,prerjen dhe transportin e trupave,shfrytëzim pylli etj.

Kundër vendimit lejohet ankim në shkallë të dytë.

Tiranë më dt.13.9.1993

GJYQTARE

Florina Tegu



7-82

ITALDRURI ELBASAN
ELBASAN (ALBANIA/SHKJIPNI)

SOCIETÀ MISTA ITALO ALBANESE
SHOQËRIA E PËRBASHKËT ITALO-SHQIPËTARE

☎ N° 003555 45 3217 - 2343
Fax N° 003555-45-2343

K E R K E S E

KERKUESI: " ITALDRURI ELBASAN SHPK " me seli ne Elbasan te Republikes se Shqiperise.

OBJEKTET:

Kerkoj regjistrimin si person juridik sipas ligjit Nr.7667 date 28.I.1993 " Per regjistrimin tregetar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregetare".

GJYKATES SE RRETHIT

TIRANE

Me vendim te gjykates se rrethit te Elbasanit Nr.5868 date 31.03.1993 " ITALDRURI ELBASAN SHPK" eshte regjistruar si person juridik dhe prej asaj kohe po zhvillon aktivitet sipas objektit te percaktuar ne vendimin e kesaj gjykate.

Ne baze te nenit 64 te ligjit Nr.7667 date 28.01.1993 " Per regjistrimin tregetar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregetare", ndermarrja e perbashket shqiptaro-italiane " ITALDRURI ELBASAN " eshte shnderruar ne shoqeri me pergjegjesi te kufizuar " ITALDRURI ELBASAN SHPK".

Shoqeria ka per objekt te aktivitetit te saj: Prodhimin dhe tregetimin e gjysem produkteve dhe produkteve te perfunduara prej druri te cilat: derrase te sharruar, parket, kompensato, rimeso, fiber, prodhime te mobilerise (karrike, divane, dollape, bufe etj.), porta dhe dritare, panele zdrukthi, etj. Shoqeria gjithashtu te realizoje vepra civile dhe industriale (vepra hidrike, kanalizime, impiante pastrimi uji, gaz-sjellsa, ndertesa civile, rruge etj.), si dhe administrimin e sherbimeve te cdo lloji (sherbime ujore ,urbane dhe per ujitje, shperndarje te gazit te metanit etj.)


Shoqeria do te zhvilloje çfardo aktiviteti tjeter te lidhura me ato te permendura me siper duke futur dhe transportin e materialeve te ndryshme, mirembajtjen dhe riparimin e mjeteve te transportit dhe kolaudimin e tyre, pyllezimin dhe ripyllezimin e tyre, prerjen dhe transportin e trupave, shfrytezimin e pyllit, etj.

Ne perputhje me nenin 2 dhe 5 te ligjit 7512 date 10.08.1991 " Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire te pavarur dhe privatizimin", te ligjit 7594 date 04.08.1992 " Per investimet e huaja" dhe autorizimit Nr.21 date 18.03.1993 me numur protokolli 540/1 te Ministrise se Tregetise dhe Bashkepunimit Ekonomik me Jashte, te letrave Prot.Nr.4412 te 3.08.1993 e Nr.4657 te 1.09.1993 te Ministrise se Industrise si dhe te mbledhjes se asamblese se ortakeve te ndermarrjes se perbashket te dates 9.9.1993, ju paraqes kete kerkese qe pasi te shqyrtohet nga ana juaj te vendoset sipas objektit te saj.

K E R K U E S I

ADMINISTRATORI I "ITALDRURIT ELBASAN SHPK"

ANTONIO AMMENDOLA



Elbasan, me 10.09.1993

KONTRATE - AKT THEMELUES
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
" ITALDRURI ELBASAN SHPK "



Ndermarrjet shqiptare :

- Kombinati i drurit, ndermarrja e mobiljeve dhe e karrikeve, ndermarrja e kompesates, ndermarrja e rimesos te perfaqesuar nga Ing. Petrit Saliu, lindur ne Peqin (Shqiperi) me 04-02-1951 ne kete rast i autorizuar me shkresen Nr. 4657 te dates 01-09- 1993 nga Ministria e Industrise Surimeve Minerare dhe Energjitike e Shqiperise (qe i bashkengjitet aktit ne fjale).
- NETTIS IMPIANTI s.r.l. e Asquaviva delle Fonti (Bari, Italia) e perfaqesuar nga Presidenti i Keshillit Administrativ Z. Giuseppe Nettis dhe nga Drejtori Administrativ Z. Francesco Piragina

DUKE PRANUAR

- a) qe me date 14-12-1992 ndermarjet e mesiperme kane themeeluar nje ndermarrje te vetme italiane-shqiptare per te ushtruar aktivitet ekonomik te perbashket te emertuar " ITALDRURI ELBASAN" ;
- b) qe Ministria e Tregtise dhe e Bashkepunimit Ekonomik me Jashte e Republikes se Shqiperise ka ilesuar autorizimin Nr.21 te dates 18-03-1993 sipas neneve 2 e 5 te ligjeve shqiptare nr. 7512/1991 dhe nr. 7594/1992 per krijimin e nje joint-venture italiane-shqiptare ;
- c) qe ndermarrja e perbashket ITALDRURI ELBASAN ka qene e regjistruar prane gjykates se Elbasanit me vendimin Nr. 5868 te 31-03-93 ku ka qene depozituar kontrata, statutit dhe studimi tekniko-ekonomik i joint-venture;
- d) qe shteti shqiptar ka shpallur ligjet Nr. 7638 te 19-11-1992 mbi shoqerite tregtare dhe Nr.7667 te 28-01-93 mbi formalitetet e regjistrimit te shoqerive tregtare;
- e) qe palet si me siper pranuar kerkojne te vazhdojne aktivitetin e joint-venture tashme te krijuar ne formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar;

Per gjithcka qe behet e ditur me siper, ndermarrjet e siperpermendura me ane te perfaqesuesve perkates, bien dakord e nenshkruajne per sa vazhdon :



NETTIS IMPIANTI s.r.l.
IL PRESIDENTE DEL
CONSIGLIO D'AMMINISTRAZIONE
(GIUSEPPE NETTIS)

NETTIS IMPIANTI s.r.l.
CONSIGLIERE DELEGATO
(FRANCESCO PIRAGINA)

NENI 1

Kushtet paraprake jane pjese perberese e aktit prezent, te gjitha dokumentat ne te, te cituara jane pjese perberese edhe se jo bashkangjitur materialisht me aktin prezent.

Mbesin te pandryshueshme dhe te vlefshme te gjitha detyrimet e marra persiper nga palet me joint-venture te 14-12-1992 dhe qe do te jene te realizuara nepermjet shoqerise se perbashket te krijuar me aktin ne fjale.

Rregullat e joint-venture kuptohen pra te zevendesuara nga ato te aktit ne fjale, dhe ne qdo rast shoqerise "ITALDRURI ELBASAN SHPK" i takojne te gjitha lehtesirat fiskale e te pergjithshme ne fuqi ne epoken e themelimit te joint-venture.

NENI 2

Themelohet nje shoqeri e perzier me pergjegjesi te kufizuar per te ushtruar aktivitet ekonomik te perbashket e quajtur "ITALDRURI ELBASAN SHPK".

Kjo shoqeri do te kete seline e saj ne Republiken e Shqiperise ne Elbasan dhe do te ushtroje aktivitetin e saj per nje periudhe prej 20 (njetzet) vjetesh, duke u nisur nga regjistrimi ne gjykatën e Tiranës dhe me perjashtim te zgjatjeve te aprovuara nga Asamblea e Ortakeve.

NENI 3

Shoqeria eshte person juridik dhe aktivitetet e saj jane te rregulluara nga dispozitat e kesaj kontrate, te statutit, te dokumentave bashkelidhur saj dhe nga legjislacioni shqiptar, ne menyre te vecante nga ligji 7496 te 04-08-1992 " Ligji per Investimet e Huaja " dhe nga ligji Nr. 7638 i 19-11-1992 " Per Shoqerite Tregtare ".

Statuti i shoqerise i bashkengjitet kontrates dhe eshte pjese perberese e saj se bashku me dokumentat bashkengjitur.

Per detyrimet shoqerore pergjigjet shoqeria me pasurine e saj siq eshte parashikuar nga neni 37 i ligjit 7638/1992.

Shoqeria eshte e lire te kete maredhenje me persona juridike dhe fizike, shqiptare ose te huaj, per nje pjese o per te gjithe aktivitetin e zhvilluar.

NENI 4

Shoqeria ka per objekt te aktivitetit te saj vazhdimin e aktivitetit te zhvilluar nga joint-venture per te cilen flitet ne premisen (a) dhe keshtu si prodhimin dhe tregtimin e gjysem produkteve dhe produkteve te perfunduara prej druri te cilat : derrase te sharruar, parket, kompesato, rimeso, fiber, prodhime te mobilerise (karrike, divane, dollape, bufe, etj), porta dhe dritare, panele zdrukthi, etj.

2

NETTIS IMPIANTI s.r.l.
IL PRESIDENTE DEL
CONSIGLIO D'AMMINISTRAZIONE
(GIUSEPPE NETTIS)

NETTIS IMPIANTI s.r.l.
IL CONSIGLIERE DELEGATO
(FRANCESCO PIRAGINA)



Handwritten signature

Shoqeria do te munde gjithashtu te realizoje vepra civile dhe industriale (vepra hidrike, kanalizime, impiante pastrimi uji, gaz-sjellsa, ndertesa civile, rruge, etj) per me teper edhe administrimin e sherbimeve te qdo lloji (sherbime ujore, urbane dhe per ujitje, shperndarje te gazit te metanit, etj). Shoqeria do te mund te zhvilloje qfardo aktiviteti tjeter te lidhura me ato te permendura me siper duke futur dhe transportin e materialeve te ndryshme, mirembajtjen dhe riparimin e mjeteve te transportit dhe kolaudimin e tyre, pyllezimin dhe ripyllezimin e tyre, nxjerrjen e transportin e trupave, shfrytezimin e pyllit, racional dhe ruajtes, etj.

NENI 5

Kapitali fillestar i shoqerise eshte 3.601.401 (tre milion e gjashteqind e nje mije e katerqind e nje) USD dhe eshte i perbere nga shumet e derdhura ne para dhe kontributeve te dorzuara ne natyre nga ortakët.

(USD)	Kapitali ne natyre	Kapitali ne para	Shuma
- Ndermarrja Kombinatit Drurit	1.309.801	/	1.309.801
- Ndermarrja Mobilje-Karrike	192.400	/	192.400
- Ndermarrja Komposatos	168.440	/	168.440
- Ndermarrja Rimesos	93.760	/	93.760
TOTALI PJESES SHQIPTARE	1.764.401	/	1.764.401
- NETTIS IMPIANTI s.r.l	1.426.951	410.049	1.837.000

Aprovohet dhe bashkangjitet relacioni i detajuar i vleresimit te kapitalit ne natyre te dorezuar nga ortakët i redaktuar nga Ing. Nuri Hasa qe ortakët e emerojne ekspert ne perputhje me nenin 42 te ligjit 7638/1992.

Vijne te bashkengjitura deklarata e derdhjes se kapitalit te dorezuar ne para nga NETTIS IMPIANTI s.r.l.

Kapitali i shoqerise eshte ndare me kuota me vlere sejcila te nje dollari amerikan.

Duke patur ne konsiderate kapitalin e sjelle nga ortakët, kuotat e pjesmarrjes ne shoqeri jane te meposhtme :

	NR.KUOTA TE ZOTERUARA	E BARABARTE ME
- NETTIS IMPIANTI s.r.l.	1.837.000	51 % (pesedhjete e nje perqind)
- Ndermarrja e Kombinatit te Drurit, Mobiljeve e Karrikeve, Komposatos, e Rimesos	1.764.401	49 % (dyzetenente perqind)
TOTALE	3.601.401	100 %



Handwritten signature



Te gjithë pasuritë e dorezuara nga ortakët janë të vena në dispozicion të shoqërisë.

Brenda vitit të dytë të aktivitetit të shoqërisë, ortakët NETTIS IMPIANTI s.r.l. do të kujdeset të dorëzojë me para o në natyrë një kuotë të metejshme kapitali e barabartë me 1.503.000 USD (një milion e pesëqind e tre mijë), që do të jenë në dispozicion të shoqërisë për programin e investimeve të stabilizuar.

Brenda vitit të tretë të aktivitetit të shoqërisë, ortakët NETTIS IMPIANTI s.r.l. do të kujdeset të dorëzojë në para o në natyrë një kuotë të metejshme kapitali e barabartë me 1.660.000 USD (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë) që do të jenë në dispozicion të Këshillit Administrativ të shoqërisë për programin e investimeve të akorduara.

Konkretizimi i kontributeve të mesipërme të kapitalit do të bëhet me mendim të Asamblesë së Ortakëve që do të regjistrohen sipas ligjit.

Në rastin e dorëzimeve në natyrë vendimet duhet të aprovohen relacionin e vlerësimit që do të jetë redaktuar nga po Ing. Nuri Hasa, i cili ekspert në përputhje me nenin 42 të ligjit 7638/1992.

Kontributet e mesipërme të kapitalit do të behen vetëm nga NETTIS IMPIANTI s.r.l.

Në mënyrë korisponduese me konkretizimin e kontributeve të kapitalit NETTIS IMPIANTI, do të modifikohen kuotat e pjesëmarrjes së kapitalit të shoqërisë në mënyrë proporcionale me atë të dorëzuar.

Gjithçka duhet të bëhet e përmendur në vendimet e Asamblesë së Ortakëve dhe në librin e ortakëve që do të plotësohet nën kujdesin e Asamblesë së Ortakëve dhe që do të përmbajë të dhënat identifikuese të ortakëve, kuotat e pjesëmarrjes, transferimet eventuale ose shitblerjen e kuotave, etj.

Libri i ortakëve do të vertetohet periodikisht nga një person zyrtar ose noter.

Rritjet e kapitalit në vazhdim dhe të metejshme nga ato të përmendura më sipër do të jenë të hapura për tu bërë nga të gjithë ortakët sipas rregullave të legjislationit në fuqi e në mënyrë të veçantë të nenëve 62 e 63 të ligjit 7638/1992.

NENI 6

Kapitali themelor i shoqërisë sipas nenit 5 të mëparshëm përfaqëson pasurinë e shoqërisë, mjetet themeluese, të xhiros, etj, të nevojshëm për aktivitetin e saj.

Të gjitha mjetet (para o pasuri) përberese të kapitalit regjistrohen në një libër të veçantë të vertetuar periodikisht nga një person zyrtar ose noter.

Veprimet financiare që lidhen me kapitalin e shoqërisë dhe aktivitetit të saj do të kryhen nepermjet të instituteve financiare shqiptare o të huaj dhe duke respektuar normat e stabilizuara nga Banka e Shqipërisë prane se ciles shoqëria do të hape një llogari rrjedhese.

Në datën e skadences o të prishjes, kur nuk do të ketë zgjatje

NETTIS IMPIANTI s.r.l.
IL PRESIDENTE DEL
CONSIGLIO D'AMMINISTRAZIONE
(GIUSEPPE NETTIS)

4
NETTIS IMPIANTI s.r.l.
IL CONSIGLIERE DELEGATO
(FRANCESCO PIAGINA)



Handwritten signature



afati kapitali i shoqerise, mbasi te hiqen debite e saj, do te ndahen proporcionalisht ndermjet ortakeve sipas kuotes se pjesmarrjes.

Asamblea e ortakeve qe aprovon skadencen ose shperberjen e shoqerise ka te drejten te stabilizoj qe pasurite e corezuara ne natyre dhe akoma ne gjendje pune ne stabiliment do ti jepen ortakeve respektive qe i kane dorezuar, duke mbajtur te pandryshuar principin e proporcionalitetit respektivisht te kuotave te pjesmarrjes.

Variacionet ne pasurine e shoqerise ilustrohen qdo vit ne bilancin qe do te redaktohet sipas principeve te ligjshmerise shqiptare dhe per sa eshte e mundur, konform me normat kryesore te kontabilitetit italian.

NENI 7

Shoqeria fiton personalitetin juridik dhe fillon aktivitetin e saj nga dita e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar. Shoqeria pushon aktivitetin e saj pas 20 vjetesh nga dita e regjistrimit, perjashtuar zgjatjet e aprovuara nga Asamblea e Ortakeve.

Fitimi i realizuar nga shoqeria, mbas pagimit te detyrimeve legale, do te taksohet sipas legjislacionit shqiptar aktual.

Fitimi qe mbetet mbasi qe i zbriten fondet rezerve dhe financiare te veçante, do te ndahen ndermjet ortakeve proporcionalisht sipas perqindjes se pjesmarrjes ne kapital.

Pjesa e fitimit qe i takon shoqerise se huaj mund te jete lirisht e transferuar ne Itali siç eshte parashikuar nga legjislacioni shqiptar aktual.

NENI 8

Aktiviteti ekonomik i shoqerise dhe investimet e personave te huaj ne te jane te mbrojtura nga shteti shqiptar, i cili i siguron atyre, kushtet e barabarta me ate te personave juridike shqiptare perveç atyre te parashikuara nga ligji Nr. 7496 i 04-08-1992 " Ligji per investimet e huaja".

Shoqeria eshte e qarte qe perfiton te gjithë kushtet lehtësuese fiskale e te pergjithshme te stabilizuara nga legjislacioni aktual shqiptar.

NENI 9

Ortaku i huaj eshte i detyruar per :

- Te vere ne dispozicion te shoqerise se perbashket mjetet teknike dhe financiare te stabilizuara nga kontrata dhe statuti sipas koheve dhe modaliteteve te pranuar;
- Te marre pjese faktikisht ne administrimin e shoqerise, ne organizimin dhe ne drejtimin e prodhimit dhe te aktiviteteve te tjera te ndermarrjes.
- Ti furnizoj shoqerise se perbashket te dhenat dhe njohjet e nevojeshme per perpunimin e programeve dhe per drejtimin

NETTIS IMPIANTI s.r.l.
IL PRESIDENTE DEL
CONSIGLIO D'AMMINISTRAZIONE
(GIUSEPPE NETTIS)

5
NETTIS IMPIANTI s.r.l.
IL CONSIGLIERE DELEGATO
(FRANCESCO PIRAGINA)



Handwritten signature

- menazherial te strukture teknike, organizative dhe tregtare.
- Te siguroje asistencen per kualifikimin e personelit shqiptar.

Ortaku shqiptar eshte i detyruar per :

- Te vene ne dispozicion te shoqerise te gjitha ndertesat, makinerite, atrecaturat, etj, te konkorduara si dhe krahun e punes dhe personelin e nevojshem.
- Te marre pjese aktivisht ne administrimin e shoqerise, ne organizimin dhe drejtimin e prodhimit dhe te aktiviteteteve te tjera te ndermarrjes.

NENI 10

Organet e shoqerise jane :

- Asambleja e Ortakeve
- Presidenti i Asamblese se Ortakeve ose i shoqerise.
- Nje ose me shume administratore.
- Nje ose me teper eksperte te kontabilitetit, neqoftese emerohen.

Menyra e krijimit te tyre dhe e funksionimit jane te percaktuar ne statusin e shoqerise.

Z. GIUSEPPE NETTIS lindur ne **Acquaviva Fonti, Italia** me 19/7/43 emerohet per tre vitet e para te aktivitetit President i Asamblese se Ortakeve (shoqerise).

Z. ANTONIO AMMENDOLA lindur ne GRUMO APPULA (BARI) me 22.09.1947 emerohet per tre vitet e para te aktivitetit Administrator i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve do te procedoje ne emerimin e ekspertit o te eksperteve te kontabilitetit kur te verifikohen kushtet minimale te parashikuara nga neni 65 i ligjit 7638/1992.

Ing. Petrit Saliu delegohet te kryej te gjitha formalitetet per regjistrimin e shoqerise prane organeve kompetente.

NENI 11

Ortaket jane te detyruar te ruajne karakterin e rezervuar te dokumentacionit, te informacioneve dhe eksperiencas se shkëmbyer ose te realizimeve te shoqerise dhe te perdorin te gjitha mjetet e nevojshme per mosperhapjen edhe pjeserisht te ketyre informacioneve.

Ortaket qe nuk i permbahen detyrimit te ruajtjes pergjigjen vete, kur kjo ndodh per rjedhoje te cfardo veprimi te vetedijshem o te paveteditshem.

NENI 12

Hegja dore nga kuota e vet e kapitalit mund te behet nga ortaket siq eshte parashikuar ne nenin 7 te statutit.

NETTIS IMPIANTI s.r.l.
IL PRESIDENTE DEL
CONSIGLIO D'AMMINISTRAZIONE
(GIUSEPPE NETTIS)

NETTIS IMPIANTI s.r.l.
IL CONSIGLIERE DELEGATO
(FRANCESCO BRAGINA)



Handwritten signature

NENI 13

Gjithë mosmarrjeveshjet që nuk mund të zgjidhen me vota në Asamble, do të zgjidhen nga forma arbitrazi që do të përbehet dhe do të vendose siç është parashikuar në statut.

NENI 14

Dispozitat e detajuara të shoqërisë janë përcaktuar nga statuti. Shpenzimet për krijimin e shoqërisë janë në ngarkim të saj. Materialet që i bashkëngjiten kontratës së mesipërme janë :

- Shkresa Nr. 4657 datë 01-09-1993 e Ministrit të Industrisë shqiptare.
- Relacioni i vlerësimit nga Ing. Nuri Hasa mbi kapitalin e dorezuar
- Statusi i shoqërisë


NENI 15

Kjo kontratë dhe materialet që i bashkëngjiten plotësohen në katër kopje, nga të cilat :

- Nr. 2 në gjuhën shqipe
- Nr. 2 në gjuhën italiane.


Per NETTIS IMPIANTI s.r.l.

NETTIS IMPIANTI s.r.l.
IL PRESIDENTE DEL
CONSIGLIO D'AMMINISTRAZIONE
(GIUSEPPE NETTIS)



Elbasan me, 10/9/1993

NETTIS IMPIANTI s.r.l.
IL CONSIGLIERE DELEGATO
(FRANCESCO PIRAGIN)



Per KOMBINATIN e DRURIT
-KOMBINATI DRURIT, NDERMARRJA e
MOBILJEVE, e KOMPESATES, dhe e
RIMESOS

Ing. PETRIT SALIU





STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ITALDRURI ELBASAN SHPK"

NENI 1

Shoqeria eshte person juridik dhe aktivitetet e saj jane te rregulluar nga dispozitat e kontrates themeluese, te statutit e te lidhseve te tij dhe nga legjislacioni shqiptar, ne vecanti nga ligji Nr. 7496 i 04-08-1992 " Ligji per Investimet e Huaja" dhe nga ligji Nr. 7638 i 19-11-1992 " Ligji mbi shoqerite tregtare".

NENI 2

Shoqeria ka per objekt te aktivitetit te saj vazhdimin e aktivitetit te zhvilluar nga joint-venture per te cilen flitet ne premisen (a) dhe keshtu si prodhimin dhe tregtimin e gjysem produkteve dhe produkteve te perfunduara prej druri te cilat : derrase te sharruar, parket, kompesato, rimeso, fiber, prodhime te mobilerise (karrike, divane, dollape, bufe, etj), porta dhe dritare, panele zdrukthi, etj.

Shoqeria do te munde gjithashtu te realizoje vepra civile dhe industriale (vepra hidrike, kanalizime, impiante pastrimi uji, gaz-sjellsa, ndertesa civile, rruge, etj) per me teper edhe administrimin e sherbimeve te cdo lloji (sherbime ujore, urbane dhe per ujitje, shperndarje te gazit te metanit, etj).

Shoqeria do te mund te zhvilloje cfardo aktiviteti tjeter te lidhura me ato te permendura me siper duke futur dhe transportin e materialeve te ndryshme, mirembajtjen dhe riparimin e mjeteve te transportit dhe kolaudimin e tyre, pyllezimin dhe ripyllëzimin e tyre, nxjerrjen e transportin e trupave, shfrytezimin racional dhe ruajtës te pyllit, etj.

Shoqeria mund te kryej te gjithë operacionet e tundshme, te patundshme, tregtare, industriale, financiare te nevojshme dhe te dobishme per arritjen e objektit shoqeror.

NENI 3

Shoqeria ka qendren e saj ne Republiken e Shqiperise ne Elbasan. Ajo mund te krijojë filiale, dege, dhe perfaqesime edhe ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte saj.

Njesite strukturore te shoqerise, deget, filialet, perfaqesite e saj themelohen ne baze te legjislacionit shqiptar dhe te legjislacioneve te vendeve ku do te ndertohen.

NENI 4

Shoqeria pergjigjet per detyrimet e saj vetem me fondet e saj, siç eshte parashikuar dhe ne nenin 37 te ligjit 7638/1992.

NETTIS IMPIANTI s.r.l.
A. PRESIDENTE DEL
CONSIGLIO D'AMMINISTRAZIONE
(GIUSEPPE NETTIS)

NETTIS IMPIANTI s.r.l.
IL CONSIGLIERE DELEGATO
(FRANCESCO PIRAGINA)





NENI 5

Ortakët kanë keto të drejta themelore :

- Të administrojnë aktivitetin e shoqërisë në përputhje me kontratën, statusin dhe dokumentat e bashkëngjitur.
- Të marrin pjesë në rezultatet, në çfardo formë të tyre dhe sasi të mbajtura për shprehjen e aktivitetit të shoqërisë.
- Të marrë pjesë me përfaqësuesit e vet në organet e shoqërisë sipas rregullave të këtij statuti.
- Të marrë të gjithë të dhënat që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike e financiare të aktivitetit të shoqërisë, dhe të gjithë dokumentat e përpunuara nga ajo, si bilancet dhe llogaritë ekonomike në Shqipëri dhe në Itali.
- Të marrë pjesë në marrjen e vendimeve në asamblë rreth aktivitetit të ndërmarrjes dhe vërejtje mbi punën e administratorëve ose të organeve të tjera të shoqërisë.
- Të heqë dorë nga shoqëria, duke ofruar kuotën e vet ortakëve të tjerë, kur ortakët e tjerë nuk e ushtrojnë të drejtën e preferencës, kuota mund t'i lihet të tretëve por vetëm siç parashikohet në nenin 7.

NENI 6

Ortakët kanë detyrime themelore të parashikuara nga kontrata dhe dokumentat e saj të bashkëngjitura.

NENI 7

Çdo ortak ka të drejtën të shesë kuotën e tij të pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë me procedurën e parashikuar nga neni 47 i ligjit 7638/1992.

Kjo shitje nuk e cliron ortakun nga detyrimet që ka pranuar përpara ndaj shoqërisë dhe nuk pezullon detyrimet e shoqërisë ndaj ortakut.

Ortakut që shet duhet në mënyrë prioritare t'i afrojë kuotën e tij ortakëve të tjerë në proporcion me kuotat e zotëruara dhe kur keto të fundit nuk pranojnë të blejnë, mund të shesë kuotat e zotëruara të tretëve, por me një çmim jo më të ulët se ai që i ka ofruar ortakëve (e drejta e parablerjes).

Në çdo rast asamblëa e ortakëve mund të vendosë për mosshitjen e kuotave të tretëve jo të pelqyeshëm.

NENI 8


Aktiviteti i shoqërisë realizohet në baze të eficiencës ekonomike dhe reflektohet në bilanci dhe saj, objektivi i eficiencës drejtohet për maksimumin e fitimit.

NENI 9

Për të bërë të mundur zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë

NETTIS IMPIANTI s.r.l.
IL PRESIDENTE DEL
CONSIGLIO D'AMMINISTRAZIONE
(GIUSEPPE NETTIS)

NETTIS IMPIANTI s.r.l. 2
IL CONSIGLIERE DELEGATO
(FRANCESCO PIRAGINA)



Handwritten signature



ortaket vejne ne dispozicion nje kapital fillestar prej 3.601.401 (tremilion e gjashteqinde nje mije e katerqind e nje) USD qe paraqet burimin fillestar per krijimin e kapitalit baze.

Ortaket marrin pjese ne themelimin e kapitalit te shoqerise me kuotat e treguara ne kontrate per themelimin e shoqerise, per sa eshte stabilizuar ne nenin 5 te kontrates.

Menyrat dhe afatet e derdhjes se kuotave te kapitalit te shoqerise jane percaktuar nga asambleja e ortakeve.

Administrata dorzon nje dokument qe verteton derdhjet e shumave ose te kontributeve ne natyre qe kryhen nga ortaket.

NENI 10

Kur shoqeria nderpret aktivitetin e saj, kur ka paguar te gjitha detyrimet qe ka marre, shuma e mbetur e kapitalit dhe e fitimit ndahet ndermjet ortakeve ne menyre propocionale me kuotat qe ata kane vene per te krijuar dhe rritur kapitalin e shoqerise, duke zbatuar persa eshte percaktuar ne nenin 6 te aktit te themelimit.

NENI 11

Shoqeria eshte pronarja e pasurive te saj dhe ka te drejten e perdorimit dhe te zoterimit te ketyre pasurive, sipas qellimeve dhe objektivave te aktivitetit qe ajo kryen.

Shoqeria ka te drejten e mbrojtjes te pasurive ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 12

Shoqeria krijon fondin e rezerves dhe fondet e tjera financiare te vecanta (per zhvillimin e saj, per nxitje ekonomike, te valutes etj.)

Formimi dhe shuma e pergjitheshme e fondit rezerve, perdorimi dhe rregullat e cdo fondi te vecante jane te percaktuara nga asambleja e ortakeve, konform legjislacionit shqiptar.

Shoqeria disponon totalisht mjetet e saj financiare. Detyrimet qe mund te lindin gjate aktivitetit te saj, mbulohen me pasurine e shoqerise duke perfshire ketu te gjithe fondet.

NENI 13

Fitimi bruto i shoqerise pas zbritjes se amortizimit te te gjithe pasurive te tundshme e te patundshme, sipas keshteve te percaktuara, te kuotave qe kane te bejne me kredite per investime, te rrogave e pagave, te shpenzimeve per lendet e para, per lendet ndihmese, per energjine, shpenzimet e pergjithshme te reparteve dhe shoqerise dhe per ato te lidhura per shpikje prodhuese dhe joprodhuese, tathet nga Ministria e Financave sipas legjislacionit shqiptar dhe pjesa qe mbetet ndahet ndermjet

NETTIS IMPIANTI s.r.l.
IL PRESIDENTE DEL
CD: SINDACO D'AMMINISTRAZIONE
(GIUSEPPE NETTIS)

NETTIS IMPIANTI s.r.l. 3
IL CONSIGLIERE DELEGATO
(FRANCESCO PIRAGINA)





ortakeve proporcionalisht me kuotat e pjesmarrjes ne kapitalin e shoqerise, perjashtuar vendime te ndryshme te asamblese se ortakeve.

Para ndarjes se fitimit hiqet fondi i rezerves.

Fitimi qe i takon ortakut te huaj, pas pageses se taksave qe ekzistojne ne Shqiperi mund te transferohet jashte shtetit pa asnje pengese.

NENI 14

Pasurite e shoqerise vlersohen ne bilancet e saj me vlera te shprehura ne monedha shqiptare dhe ne monedhe te huaj sipas ligjeve perkatese qe jane te aplikuar ne Shqiperi.

Bilanci vjetor paraqitet brenda afateve te parashikuara nga ligji 7638/1992.

Forma e bilanceve dhe e llogarive ekonomike e shoqerise eshte percaktuar nga administratori, duke mbajtur parasysh dhe formen e bilanceve dhe te llogarive ekonomike specifike per ndermarrjet industriale, gjithnje duke respektuar legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Çdo vit financiar fillon me 1 Janar e perfundon me 31 Dhjetor perveç vitit te pare qe fillon nga momenti i marrjes se personalitetit juridik dhe mbaron me 31 Dhjetor.

NENI 15

Organi vendimor i shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve.

Asambleja paraqet universalitetin e ortakeve dhe te vendimeve te saj, te marra ne perputhje me ligjin, me aktin themelues dhe me kete statut nga ku kane detyrime te gjithe ortakët.

Ben pjese ne të ortakët qe kane te drejten e votes proporcionalisht me madhesine e shumave te kapitalit te derdhur.

Çdo ortak ka te drejten e nje vote per çdo pike perqindje te kapitalit te nenshkruar.

Asambleja e ortakeve vendos per bilancin vjetor, per ndryshimet ne statut, per rritjen ose zvoglimin e kapitalit te shoqerise, per emerimin e administratoreve, per nderprerjen ose shtyrjen e aktivitetit te ndermarrjes dhe per çfardo vendim tjeter te rezervuar nga ajo nga akti themelues, nga statuti dhe nga ligji ne fuqi.

Asambleja vendos me shumicen e votave ose me vote ne favor te nje ose me shume ortakeve qe perfaqesojne shumicen e kapitalit, perveç rasteve ne te cilen ligji parashikon shumica te ndryshme.

Asambleja kryesohet nga Presidenti i asamblese se ortakeve (te shoqerise). Presidenti i asamblese se ortakeve zgjidhet per here te pare gjate aktit themelues dhe ne vazhdim nga asambleja, per nje periudhe jo me teper se 3 vjet por me mundesi qe te rizgjidhet.

Presidenti ka detyre qe :

- Te therrese asamblene e ortakeve dhe te organizoje punen.
- Te ndjeke vendimet e asamblese duke siguruar nje aplikim te sakte te vendimeve te marra.

NETTIS IMPIANTI s.r.l.
IL PRESIDENTE DEL
CONSIGLIO D'AMMINISTRAZIONE
(GIUSEPPE NETTIS)

NETTIS IMPIANTI s.r.l.
IL CONSIGLIERE DELEGATO
(FRANCESCO PIRAGINA)



Handwritten signature



Asambleja e ortakeve thirret se paku nje here ne vit duke i paranjoftuar ortaket 15 dite perpara duke i derguar njoftim me shkrim ose me poste rekomande.

Asambleja duhet te thirret kur kerkohet nga ortaket ose organe te tjera te shoqerise siq eshte parashikuar edhe nga ligji 7638/1992.

Asambleja qe nuk thirret me paranjoftim jane te vlefshme ndonese totalitare.

Te gjitha vendimet e asamblese shkruhen ne nje liber periodikisht te vertetuar nga noteri o person zyrtar.

NENI 16

Organi administrativ i shoqerise eshte nje ose me shume administratore, qe jane te emeruar per here te pare gjate themelimit te shoqerise dhe ne vazhdim nga asambleja e ortakeve.

Administratoret qendrojne ne detyre per nje kohe jo me te madhe se 3 vjet por mund te rizgjidhen.

Asambleja e ortakeve ka te drejten qe ne qdo moment te heqe nga detyra nje ose te gjitha administratoret dhe ti zevendesoje me persona te tjere.

Te gjitha vendimet e nje rendesie te vecante te pershtatura nga administratoret shkruhen ne nje liber te posaqem qe vertetohet periodikisht nga noteri ose nje person publik.

NENI 17

Administratoret kryejne gjithë operacionet qe kane te bejne me aktivitetin e shoqerise te administrimit te zakonshem dhe jo te zakonshem dhe kane te drejten te kryejne te gjitha veprimet qe i quajne te nevojshme per konkretizimin dhe arritjen e qellimeve te shoqerise duke perjashtuar vetem ato qe ligji ne menyre taksative ja rezervon asamblese.

Kompetencat e administratoreve ne menyre te shprehur por jo te plote jane :

- Formulimi i bilancit dhe i llogarive ekonomike.
- Ndryshimi i aktivitetit te prodhimit qe realizohet dhe i aktiviteteve qe duhet te kryhen, qe bejne pjese ne objektin shoqeror te shoqerise.
- Propozime per asamblene e ortakeve per ndryshime ne kapitalin e shoqerise.
- Percaktimin e regjimit dhe te kushteve te aplikimit te llogarive dhe te llogarise ekonomike dhe te bilancit.
- Percaktimi i rregullave dhe normativave qe percaktojne raportet e ekzistojne brenda shoqerise perfshire dhe personelin.
- Percaktimin e struktures se ndermarrjes.
- Percaktimin e organikes dhe ndarjen e vendeve drejtuese.
- Emerimin ose zevendesimin e drejtorit te pergjithshem ose zv/drejtorit te pergjithshem ne rast se e quan te nevojshme.
- Krijimin e organeve te tjera per realizimin e objektivave dhe te funksioneve te shoqerise.
- Paraqitja e propozimeve asamblese se ortakeve per rregullin, krijimin e fondeve te vecanta, ndarjen e fitimeve si dhe per caktimin e rregullave per te shlyer debitet.

NETIS IMPIANTI S.r.l.
IL PRESIDENTE DEL
CONSIGLIO D'AMMINISTRAZIONE
(GIUSEPPE NETTIS)

NETIS IMPIANTI S.r.l.
IL CONSIGLIERE DELEGATO
(FRANCESCO PIRAGNA)



Handwritten signature: Felicia

- Vendime per krijimin e filialeve, degeve dhe perfaqesive.
- Pregatitjen e propozimeve per nderprerjen e aktivitetit shoqerise.
- Seleksionimin e antareve te komisionit te likuidimit.
- Kryerjen e aktivitetit per likuidimin e shumave qe u takon ortakeve qe kane hequr dore.
- Vendime per debitim per nje kohe te shkurter, te mesme dhe ne afat te gjate.
- Propozime per thirjen e asamblese se ortakeve.

Administratoret mund te delegojne disa nga te drejtat e tyre prokuratoreve te trete nepermjet te nje delegimi te shkruar me firme te autentifikuar nga noteri ose person zyrtar. Administratoret jane te detyruar te pergjigjen ne kohe per cfardo lloj informacioni edhe periodik, te kerkuar nga ortaket.

NENI 18

Maredhenjet e punes ne ndermarje, filiale, dege ose perfaqesi rregullohen nepermjet te kontrates se punes. Per rastet qe nuk rregullohen me kontraten e punes zbatohen dispozitat e ligjit shqiptar.

NENI 19

Aktiviteti i shoqerise pushon mbas 20 vjetesh duke u nisur nga data e regjistrimit ne gjykate ose me shpejt ose me vone sipas propozimit te bere nga njeri prej ortakeve, aprovuar nga asambleja e ortakeve me shumicen e parashikuar ne nenin 60 te ligjit 7638/1992.

Duke arritur ne cfardo kohe dhe per cfardolloj shkak ne prishjen e shoqerise, asambleja percakton modalitetet e likuidimit dhe emeron nje komision likuidimi, duke i percaktuar fuqite sipas procedures se ligjit 7638/1992.

Percfardo rasti qe nuk rregullohet nga kontrata dhe nga statuti i shoqerise do te zbatohen normat e ligjit 7638/1992 qe ka te beje me shoqerite me pergjegjesi te kufizuar.

NENI 20

Cfardo mosmarrveshje midis ortakeve qe nuk mund te zgjidhet brenda shoqerise do te percaktohet nga nje arbitrazh qe do te funksionoj ne perputhje me rregullat arbitrare te komisionit ONU ne fushen e tregetise dhe ligjet internacionale dhe te Dhomes se Tregtise Nderkombetare te Parisit sipas procedures se saj.

Ligji qe do te aplikohet do te jete Kodi Civil Zviceran.

Per NETTIS IMPIANTI s.r.l.

NETTIS IMPIANTI s.r.l.
IL PRESIDENTE DEL
CONSIGLIO D'AMMINISTRAZIONE
(GIUSEPPE NETTIS)

NETTIS IMPIANTI s.r.l.
IL CONSIGLIERE DELEGATO
(FRANCESCO BIRAGINA)

Elbasan me, 10/09/1993

Fret Nr 3783

10-09-1993

Noteria

Z. MAJUNDA



Per KOMBINATIN e DRURIT
-KOMBINATI DRURIT, NDERMARRJA e
MOBILJEVE, e KOMPESATES, dhe e
RIMESOS

Ing. PETRIT-SALIU



Petr